



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 62, datë 24.07.2019

**PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. FIONA PAPAJORGJI NË VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DATËN 04.03.2019**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

<b>Ardian Dvorani</b>	- Kryetar
<b>Vitore Tusha</b>	- Zëvendëskryetare
<b>Arta Marku</b>	- Anëtare
<b>Margarita Buhali</b>	- Anëtare
<b>Fatjona Memçaj</b>	- Anëtare/Relatore
<b>Fatri Islamaj</b>	- Anëtar
<b>Eriol Roshi</b>	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, **z. Enio Haxhimihali**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës 17.07.2019 dhe 24.07.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATE PËR GJYQTARE**

**NË GJYKATËN KUSHTETUESE:** Znj. Fiona Papajorgji

**OBJEKTI:**

Urdhërimi i lejimit të kandidimit të znj. Fiona Papajorgji, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 04.03.2019.

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

Pasi dëgjoji relativimin e anëtarit të Këshillit, **znj. Fatjona Memçaj**, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, **z. Enio Haxhimihali**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, Kuvendi i Republikës, në datën 04.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Bashkim Dedja.
2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.
3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe znj. Fiona Papajorgji.
4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 2 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.
5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Fatjona Memçaj.
7. Znj. Fiona Papajorgji, si njëra ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Fiona Papajorgji, gjendet e administruar në dosjen e kandidates.

8. Në datën 09.04.2019, kandidatja Fiona Papajorgji është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidates të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidates.

9. Në datën 15.04.2019, kandidatja Fiona Papajorgji ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidates.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Fiona Papajorgji, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr.2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Fiona Papajorgji e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr.5/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Fiona Papajorgji dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Fiona Papajorgji dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidates Fiona Papajorgji, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me

kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidates), si më poshtë:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekteve financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Fiona Papajorgji.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr.110 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015 nga kandidatja Fiona Papajorgji.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr.1134/207 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Fiona Papajorgji .

19. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Fiona Papajorgji, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr.120 prot, datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 114 prot, datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr.118 prot, datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr.117 prot, datë 17.04.2019*).



20. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjzbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

21. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr.1545 prot., datë 10.06.2019 dhe nr.680/1 prot., datë 15.05.2019, mbi të dhënat e kërkuara për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe kandidaten Fiona Papajorgji.

22. Në vijim të procedurave të verifikimit dhe kontrollit të integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr.112 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nr. 45/2015 nga kandidatja Fiona Papajorgji për kompetencë dhe shqyrtim pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.551/1 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar vendimin nr.271 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Fiona Papajorgji .

24. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Fiona Papajorgji në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Fiona Papajorgji.

26. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, lidhur me kushtin e parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi, me shkresën nr.268 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Gjykatës Kushtetuese, pranë të cilit kandidatja Fiona Papajorgji ka ushtruar dhe vijon ushtrimin e funksioneve publike, për të dërguar të dhëna nëse ka pasur dhe ka masa disiplinore ndaj kësaj kandidateje.

27. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Gjykata Kushtetuese me *shkresën nr.144/1 prot, datë 23.04.2019.*

28. Së fundi, në lidhje me kandidaten Fiona Papajorgji, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 81 datë 26.11.2018 ka vendosur konfirmimin e saj në detyrë, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datës 12.02.2019.

29. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, duke vlerësuar paraprakisht se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtarja relatorë e Këshillit zonja Fatjona Memçaj ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

30. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit të kandidimit të zonjës Fiona Papajorgji, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

31. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidates Fiona Papajorgji.

32. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

33. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

34. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

35. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidates Fiona Papajorgji.

36. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë ku bashkëlidhur akteve të procedurës së verifikimit mungojnë edhe një pjesë dokumenteve dhe përgjigjeve të sjella nga institucionet, parashtroi se:

- ka mungesë dokumentacioni në dosjen e dërguar pranë Avokatit të Popullit që vërteton plotësimin e kriterëve dhe kushteve të tjera ligjore, mbi bazën e të cilave mund të jepen konkluzione paraprake mbi procedurën e ndjekur
- nevojitet hetim i thelluar për verifikimin e gjendjes penale për periudhën gjatë së cilës ka jetuar jashtë shtetit.

## II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

37. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatës, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidatit Fiona Papajorgji për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

38. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

*“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*

*5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”*

39. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

*“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:*

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

*2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:*

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”*

40. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr.5/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit

të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Fiona Papajorgji dhe personat e lidhur me të.

41. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Fiona Papajorgji, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë,
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë,
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

42. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidatja Fiona Papajorgji në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI dhe mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare duke ardhur në përfundimet e tij të sipërcituara, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi.

43. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshillit i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklarinet e bëra nga kandidatja Fiona Papajorgji pranë ILDKPKI me *Deklaratën e e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

44. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Fiona Papajorgji.

45. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Fiona Papajorgji ka “*kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të saj*”. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

46. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidatja Fiona Papajorgji ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

47. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr.1134/207 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Fiona Papajorgji, duke ardhur përfundimet se “Subjekti deklarues Fiona Theodor Papajorgji candidate për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”.

48. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Fiona Papajorgji, krahas plotësisimit të saktë të



formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati “ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;”. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidate nuk rezulton të jetë në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

49. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidatja Fiona Papajorgji ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

50. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.551/1 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar vendimin nr.271 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Fiona Papajorgji, duke ardhur në përfundimin se për zonjën Fiona Papajorgji, *“nga verifikimet e kryera deri tani, nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të saj, sipas Nenit 29, pika 2 të Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” ”.*

51. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Fiona Papajorgji, krahas plotësisimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara datës 2 Korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidate nuk rezulton të jetë në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

52. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidatja Fiona Papajorgji *“ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”*. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

53. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr.680/1 prot., datë 15.05.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar për verifikimin e rastit të treguar në pikën 52, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Fiona Papajorgji *“ nuk figuron e evidentuar për veprimtari kriminale.”*

54. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.1546 prot., datë 10.06.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara në pikën 52 më sipër, nga ku rezulton se *“nuk disponohen materiale implikuese ose kompromentuese për integritetin e figurës së znj. Fiona Papajorgji.”*

55. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Fiona Papajorgji nuk rezulton të jetë në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

56. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidatja Fiona Papajorgji në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kjo candidate ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të saj.

57. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja Fiona Papajorgji ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 2000, Diplomë në Shkencat Juridike (e konvertuar nga Ministria e Arsimit), në “Universitë degli Studi Aldo Moro” në Bari, Itali, Universitet Publik. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidatja Fiona Papajorgji nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

58. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidatës, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Fiona Papajorgji ka ushtruar veprimtari profesionale si :

- a) Praktikante Avokate pranë Dhomës së Avokatisë në Bari, Itali për periudhën dhjetor 2000 - janar 2004;
- b) Avokate pranë Dhomës së Avokatisë në Bari, Itali për periudhën janar 2004 - dhjetor 2008;
- c) Pedagoge efektive pranë Departamentit të Shkencave Juridike në *Albanian University*. Lënda Regjimi juridik i tokës; si dhe Grupet jofitimprurës të interesit. Bachelor, për periudhën nëntor 2007- mars 2009;
- ç) Specialiste e nivelit të lartë pranë Drejtorisë së Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve, Gjykata Kushtetuese, për periudhën mars 2009- maj 2011;
- d) Këshilltare ligjore pranë Gjykatë Kushtetuese, për periudhën 18.05.2011 dhe aktualisht;
- dh) Lektore e jashtme e së drejtës publike pranë Universitetit Zoja e Këshillit të Mirë (nëntor 2007-aktualisht), lektore për regjimin juridik të tokës, si edhe për grupet jofitimprurës të interesit pranë *Albanian University* (mars 2009 – dhjetor 2010), lektore për teknikën legjislative pranë Universitetit European të Tiranës (mars 2018-qershor 2018).

59. Bazuar në gjetjet e cituara në pikën 58 më sipër, përfshirë angazhimin e njëkohshëm si specialiste e nivelit të lartë pranë Drejtorisë së Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve në dhe si këshilltore ligjore në Gjykatën Kushtetuese edhe si lektore (pedagoge) pranë Universitetit Zoja e Këshillit të Mirë dhe Albanian University, Këshilli konstaton se kandidatja Fiona Papajorgji ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

60. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, sikurse parashtrohet në pikën 58 më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidates për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se kandidatja Fiona Papajorgji nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Fiona Papajorgji nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

61. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidates për veprimtaritë e ushtruara prej saj, si edhe shkresat me përgjigje të dërguara sipas kërkesës së Këshillit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga parti politike, Këshilli konstaton se kandidatja Fiona Papajorgji nuk rezulton që të ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Fiona Papajorgji nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

62. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatja *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, informacioni i dërguar nga Gjykata Kushtetuese *me shkresën nr.144/1 prot, datë 23.04.2019*, që janë të administruara në dosjen e kandidates, Këshilli i rezulton se, gjatë marrëdhënies së punës me Gjykatën Kushtetuese, kandidatja Fiona Papajorgji nuk ka marrë dhe nuk ka asnjë masë disiplinore apo administrative të regjistruar, që nga fillimi i marrëdhënieve të punës. Për rrjedhojë kandidatja Fiona Papajorgji nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

63. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidates, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidates Fiona Papajorgji në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/c të ligjit nr. 8577/2000 “ *Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të

shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**VENDOSI:**

1. Lejimin e kandidimit të kandidates Fiona Papajorgji, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Fiona Papajorgji.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI**

**ARDIAN DVORANI**

